

NEWSLETTER E DIASPORËS

PËRFAQËSIMI DHE NXITJA E POLITIKAVE TË BASHKËPUNIMIT DHE TË NDËRVEPRIMIT ME TË GJITHË SHQIPTARËT,
DUKE NXITUR E FUQIZUAR BASHKËPUNIMIN NË TË GJITHA FUSHAT ME SHQIPTARËT JASHTË KUFIJVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE SHTETET KU ATA BANOJNË

#11

Ministri takohet me studentët të shkollës "London School of Economics"

Ministri i Shtetit për Diasporën z.Pandeli Majko u takua me një grup studentësh të shkollës "London School of Economics", në Britaninë e Madhe.

Gjatë bashkëbisedimit me ministrin studentët shfaqën interesin për situatën politike në vendin tonë si dhe në rajon. Pjesë e grupit ishin edhe studentë shqiptarë, pjesë e Diasporës shqiptare në Britani.

Interesi i tyre gjatë bisedës u fokusua më tepër te marrëdhëniet që vendi i origjinës dhe vendi ku jetojnë, pasi në të ardhmen shohin mundësinë për tu rikthyer e për të dhënë kontributin e tyre në Shqipëri.

<https://diaspora.gov.al/ministri-takohet-me-studentet-te-shkolles-london-school-economics/>



Shfuqizohen tre urdhra të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën



Kryeministri miratoi propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën për shfuqizimin e urdhrave nr. 135, nr.136, dhe nr.138 të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare për Diasporën, të cilët konsistonin në ngritjen e grupeve të punës për përcaktimin e koordinatorëve shtetëror për informimin e Diasporës, programin vjetor të Aktiviteteve për Diasporën dhe koordinatorin e Bursave.

Tre koordinatorët e përzgjedhur nga grupet e punës janë: për informimin e Diasporës, z. Fatjon Hallkaj, Drejtor i Programimit dhe Zhvillimit në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), për Programin vjetor të Aktiviteteve për Diasporën u zgjodh zëvendësministria e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Ornela Cuci dhe coordinator i Bursave, zëvendësministri dhe Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino.

Më poshtë mund të lexoni Urdhrin dhe raportin e plotë për shfuqizimin e tij:

<https://diaspora.gov.al/shfuqizohen-tre-urdhra-te-planit-te-veprimit-te-strategjise-kombetare-per-diasporen/>

Mjekut Gani Abazi i jepet çmimi "Për merita të veçanta civile"



Gjatë takimit me mjekun Gani Abazi duke i akorduar çmimin "Për merita të veçanta civile", dhënë nga Presidenti i Republikës në Samitin e Dytë të Diasporës, për arritje të larta shkencore në fushën e mjekësisë në SHBA, duke përfaqësuar denjësisht Diasporën shqiptare.

Mbledhja e radhës e koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës



Në mbledhjen e radhës me grupin e koordinatorëve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës 2018-2024. Gjatë mbledhjes u diskutua mbi publikimin e radhës të Buletinit të Planit të Veprimit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës. Buletini i cili publikohet një herë në tre muaj është një përmbledhje e ecursisë së punës për zbatimin e masave të Planit të Veprimit.

Takimi i grupit të punës për krijimin e Pavijonit të Diasporës në Muzeun Historik Kombëtar



U mbajt mbledhja e radhës me grupin ndërinstucional të punës për krijimin e Pavijonit të Diasporës në Muzeun Historik Kombëtar.

Në mbledhje u diskutua ecuria e punës për ta bërë funksional këtë pavijon.

Në përfundim të kësaj mbledhje u vendos që grupi ndërinstucional të mbajë dhe një mbledhje të fundit për finalizimin e këtij projekti ambicioz.

Fondi i Zhvillimit për Diasporën publikon Raportin vjetor



Fondi i Zhvillimit për Diasporën publikon Raportin vjetor. Në këtë raport përmbledhet i gjithë aktiviteti i Fondit Shqiptar i Zhvillimit të Diasporës i kryer gjatë vitit 2018. Ky raport përmbledh në mënyrë të detajuar analizën financiare, strukturën administrative të fondit si dhe aktet dhe marrëveshjet e marra nga këshilli drejtues i FSHZHD gjatë vitit të kaluar. Raportin e plotë mund ta lexoni këtu:

<http://online.fliphtml5.com/dmiin/cmwj/>

Agjencia Kombëtare e Diasporës publikon pasqyrën e aktivitetit vjetor



Agjencia Kombëtare e Diasporës ka publikuar raportin vjetor për vitin 2018. Raporti përmbledh gjithë aktivitetin institucional të realizuar nga kjo agjenci si dhe pasqyrën financiare të tij. Në të gjithashtu vlerësohet edhe parashikimi i aktiviteteve për vitin 2019. Raportin e plotë mund ta lexoni këtu: <http://online.fliphtml5.com/dmiin/qpqe/>